



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim

Mbledhja nr. 83

Prishtinë, më 2.4.2024, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Fitore Pacolli-Dalipi, Besian Mustafa, Milazim Salijaj, Isak Shabani, Ekrem Mustafa, Salih Zyba, Jetmire Vrenezi dhe Albena Reshitaj.

Munguan: Samra Ilijazi dhe Ganimete Musliu.

Stafi mbështetës i Komisionit : Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e Komisionit.**

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit nga dt. 1.3.2024;
3. Shqyrtimi i Projektligjit 08-L-242 për performancën energjetike të ndërtesave;
4. Informata për tjetërsimin e pronës së UP-së të Fakulteti Teknik;
5. Formimi i grupeve punuese për projektligjet e miratuara në parim;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Milazim Salijaj, kërkoi që pika e 4 rendit të largohet nga rendi i ditës dhe të shtyhet për një mbledhje tjetër, sepse janë në pritje të një dokumenti të rëndësishëm nga gjykata, të cilin e kanë kërkuar.

Komisioni, me 5 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, e miratoi rendin e ditës me ndryshimin e propozuar nga deputeti.

2. Miratimi i procesverbalit nga dt. 1.3.2024

Komisioni, me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi procesverbalin e datës 1.3.2024.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08-L-242 për performancën energjetike të ndërtesave

Kryetarja, tha se komisioni ka formuar grupin e punës për këtë Projektligj, i cili ka përgatitë raportin me amendamente për komisionin dhe e ftoi kryesuesin e këtij grupi, deputetin Milazim Salijaj ta paraqet raportin me amendamente.

Milazim Salijaj, tha se Grupi i punës së bashku me përfaqësuesit e MMPHI-së sponsor të këtij projektligji, ka mbajtur 4 takime, ku e ka shqyrtua projektligjin nën për nen dhe pas kësaj ka propozuar 24 amendamente. Ndërsa, vetëm për amendamentin 20, që ka të bëjë me nenin 19 për gjrobat, tha se kemi kërkuar nga MMPHI- sponsor i projektligjit që t'na sigurojë se niveli i gjrobave është në rregull dhe është në përputhje me Ligjin për kundërvajtje dhe na është përcjell ky propozim ndryshim i gjrobave.

“Amendamenti 20

Neni 19, paragrafi 1, nënparagrafët: 1.1, 1.2 dhe 1.3, ndryshohen si në vijim:

- “1.1. Çdo person fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik, do të dënohet me gjobë prej një mijë (1000) euro deri në dy mijë (2,000) euro;
- 1.2. Çdo person fizik që ushtron biznes individual, do të dënohet me gjobë prej tremijë (3000) euro deri në pesë mijë (5.000) euro;
- 1.3. Çdo person juridik do të dënohet me gjobë prej dhjetë mijë (10.000) deri në njëzet mijë (20.000) euro.”

Kryetarja, pasi që nuk pati diskutues, i ftoi deputetet për votim të amendamentit 20, për Nenin 19 të propozuar nga MMPHI dhe konstatoi se me 7 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni e miratoi këtë amendament, ndërsa më pas i ftoi deputetët për votim të raportit me 24 amendamente dhe konstatoi se me 6 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohen amendamentet e Grupit të punës për Projektligjin nr.08-L-242 për performancën energjetike të ndërtesave.
2. Raporti me amendamente të procedohet te komisionet e përhershme, sipas procedurës.

4. Formimi i grupeve punuese për projektligjet e miratuara në parim,

Fitore Pacolli, kryetare, tha se dy projektligje kanë kaluar në leximin e parë në seancën e datës 28.3.2024 dhe i ftoi t'i propozojnë emrat për grupet punuese. Pas propozimeve, ajo konstatoi se Komisioni i formoi grupet punuese si vijon:

- **Grupi i punës për Projektligjin nr. 08/L-275 për Rrugët**, në këtë përbërje: *Milazim Salijaj, kryesues, Ekrem Mustafa, Isak Shabani dhe Jetmire Vrenezi, anëtarë.*
- **Grupi i punës për Projektligjin nr. 08/ L-278 për faturat e kulturave bujqësore dhe fletë magazinave**, në këtë përbërje: *Salih Zyba, kryesues, Fitore Pacolli-Dalipi dhe Besian Mustafa, anëtarë.*

6. Të ndryshme

Ekrem Mustafa, tha se bashkë me deputetin Milazim Salijaj, janë takua me banorët e fshatit Komogllavë të Komunës së Ferizaj. Ata kanë një shqetësim me kycje (lidhjen) në autostradën në Gërlicë. Janë të interesuar që mos të mbyllet rruga ekzistuese, sepse do të zgjatët rruga për të shkuar në qytetin e Ferizajt rreth 1.4 km ose në kthim 2.8 km. Komuna iu ka ofruar një zgjidhje,

por nuk dihet se deri ku kanë mbërri. Të kërkohet nga MMPHI-ja me na njoftua për këtë shqetësim të banorëve

Milazim Salijaj, shtoi se gjatë takimit me banorët e fshatit Komogllavë dhe Gërlicë, ata janë ankuar se nuk janë shpronësua dhe nuk kanë njoftim për vendimet e tilla dhe se kanë filluar punët. Ai shtoi se nuk po mund të besojë se ka filluz puna në kyçjen në autostradë, pa u kryer shpronësimi i pronave dhe është mire me pyet ministrin edhe për shpronësimin e pronave në këtë pjesë.

Kryetarja, tha se do të kërkojmë sqarim nga MMPH-ja rreth kërkesave të banorëve të fshatit Komogllavë dhe Gërlicë të Komunës së Ferizajt.

Isak Shabani, si kryesues i Grupit punues për Projektligjin për administrimin e banesave dhe lagjeve të banimit në bashkëpronësi, kërkoi në emër të grupit të punës që të realizohet një vizitë në Shqipëri. Për shkak të rëndësisë që ka ky ligj dhe për t'i marrë përvojat e tyre mjaft të mira, që sipas përfaqësuesit të MMPHI-së janë të mira dhe se ai mund ta organizojë dhe aranzhojë këtë vizitë. Pastaj të organizohet një punëtori njëditore për shqyrtimin e këtij projektligji,

Kryetarja, konstatoi se nuk ka asnjë kundërshtim në lidhje me kërkesën e grupit punues dhe se miratohet kërkesa e grupit punues për këtë vizitë dhe organizimin e punëtorisë.

Salih Zyba, për mbledhjen e radhës kërkoi që të raportojë njëri nga ministrat e linjës, së pari ai MBPZHR-së dhe pastaj ai i MMPHI-së.

Kryetarja, tha se kemi bërë kërkesë për ministrin e Bujqësisë dhe se do të kemi përgjigje nga ai dhe pastaj atë të MMPHI-së. Pra, do të kemi takime në mbledhje të ndara me dy ministrat.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Fitore Pacolli-Dalipi,

Kryetare e Komisionit